



Pranuar / Doretuar Priljena/Prodato Received/Delivered	24	10	2023	3	viti god year
Organ /Nesia Org./Jednica Org./Unit	Hr Prot Hr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SIKPM/SHCK	6673	2023	115		



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1136/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbaitëses. ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1136/2023, të datës 01.09.2023, të parashtruar nga ankuesi nga Prishtina, kundër organit të punësisimit: Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 23.10.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1136/2023, e datës 01.09.2023, e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.1326/2023 i datës 28.08.2023 i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si dhe **Anullohet** Konkursi për pranim me numër të reference RN00012425, i shpallur me datë 28.08.2023, nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për pozitën “Drejtore Ekzekutive në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale-Ministria e Shëndetësisë”.

III. Mbetet në fuqi Konkursi për pranim me numër të referencës RN00012066, i shpallur me datë 13.07.2023, nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për pozitën “Drejtore Ekzekutive në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale-Ministria e Shëndetësisë”, si dhe Njoftimi i datës 23.08.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve.

IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative në mënyrë që procedura e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00012066 të datës 13.07.2023, të vazhdoj me fazat tjera të vlerësimit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 01.09.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.1136/2023, kundër Vendimit me numër Nr.1326/2023 të datës 28.08.2023, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (*tutje vetëm DMZP*), lidhur me anulimin e Konkursit për pozitën Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale-Ministria Shëndetësisë, me pretendimet ankimore se vendimi për anulim të konkursit/ri-shpallje është i pa bazë, i pa arsyetuar dhe i pa drejtë, pasi që sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë janë plotësuar kriteret që të vazhdohet me procedurën e rekrutimit në fjalë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli*) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.09.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 29.09.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 6465/2023, të datës 09.10.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1136/2023, të datës 01.09.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 01.09.2023 me numër protokollit 5918/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 13.07.2023 me numër reference RN00012066; Njoftimin e datës 23.08.2023 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve nga DMZP-ja; Vendimin me Nr.1326/2023 të datës 28.08.2023 nga DMZP-ja lidhur me anulimin e konkursit dhe rishpalljen e tij; Konkursin e datës 28.08.2023 me reference RN00012425; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.09.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.09.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-MPB së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës si: Listën e aplikantëve me kandidatët e aprovuar dhe refuzuar e gjeneruar tek SIMBNJ; Komunikimet elektronike të datës 29.08.2023, 23.08.2023 ndërmjet zyrtarëve të DMZP-së lidhur me rastin në fjalë si dhe Vendimin për vazhdim të afatit të ankesës në Këshill me numër protokollit 6465/2023 të datës 09.10.2023, Konkursin e shkarkuar nga SIMBNJ me numër të referencës RN00012058 të datës 12.07.2023, se bashku me Njoftimin e datës 25.08.2023 lidhur me listën e ngushtë të kandidateve pjesëmarrës, Konkursin e shkarkuar nga SIMBNJ me numër të referencës RN00012129 të datës 20.07.2023, se bashku me Njoftimin e datës 01.09.2023 lidhur me listën e ngushtë të kandidateve pjesëmarrës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale Kolegji i Këshillit ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me datë 13.07.2023, ka publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ), Konkursin për praninë, me numër të referencës RN00012066, për pozitën e punës “Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale - Ministria e Shëndetësisë” klasa “Drejtues i Lartë 2”, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi. Më datë 23.08.2023, Njësia Përgjegjëse ka publikuar njoftimin hidhur me listën e ngushtë të kandidatëve, për vazhdim në fazat e mëtejme në këtë në procedurë të rekrutimit, e në të cilën listë është përfshirë edhe ankuesi.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezultojn se Drejtori i DMZP-së, me datë 28.08.2023 ka nxjerrë Vendimin me Nr.1326/2023 të datës 28.08.2023, me të cilin ka anuluar Konkursin me numër të referencës RN00012066 për pozitën Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, me arsyetimin së pika e 7 e konkursit në fjalë, përmban rregulla për njohjen dhe mënyrën e dëshmisë së përvojës së punës në institucione publike, në OJQ dhe përvojës së punës jashtë shtetit por nuk përmban rregulla për përvojën e punës së fituar në sektorin apo subjektin privat, të fituar territorit të Republikës së Kosovës ashtu sikurse përcaktohet/rregullohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin e aplikueshëm.

DMZP-ja me datë 28.08.2023 ka rishpall Konkursin për pranim me numër referencës RN00012425 për pozitën e njëjtë Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/Ministria e Shëndetësisë, me afat të aplikimit nga data 27.09.2023 deri me 04.10.2023.

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore fillimisht analizoj Konkursin për pranim me numër reference RN00012066 të datës 13.07.2023 dhe për pasojë konstatoi se si kriteret formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë: Arsimimi i kërkuar: *Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite të studimeve në drejtimit: fakulteti i Farmacisë, Ekonomikut, Juridikut, Kimisë, Mjekësisë, Biologjisë, Fizikes;* • Kualifikime të posaçme formale: • Përvoja e punës e kërkuar: *Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.* Ndërsa lidhur me dokumentacionin për aplikim, në klauzolën nr.7 të Konkursit si dokumente të kërkuara janë vendosur: • *Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit;* • *Dëshmi për përvojën e punës / vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;* • *Përvoja e deklaruar e punës, sipas kushteve të konkursit, në Organizatat Joqeveritare, dëshmohet, përkatësisht merret parasysh, nëse kumulativisht përmbushen kushtet si në vijim.* • *“Është përgjegjësi e kandidatit që të sigurojë prova specifike që tregojnë se secili prej këtyre kriterëve është përmbushur. Kandidatët gjithashtu duhet të bëjnë të qartë në aplikimin e tyre çdo përvojë pune që është fituar në një OJQ”:* • *Dëshmohet me statutin apo aktin tjetër të organizatës se pozita në të cilën është deklaruar përvoja e punës, ekziston në kuadër të organizimit dhe funksionimit të OJQ –së;* • *Aktin e emërimit apo caktimit me votim të organeve që sipas statutit të OJQ –së, kanë kompetencën për të emëruar/caktuar personat në pozitën e caktuar në OJQ;* • *Së paku njërin nga dëshmitë: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale ose të ardhurave tjera të tatueshme;* • *Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet nëse referencat e përvojës, mbështeten me aktet përkatëse noteriale;* • *letër motivimi;* • *kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës (nuk pranohen nese janë me afat të skaduar);* • *dëshmi që nuk ka një masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publik në pesë vitet e fundit (për kandidatët që janë zyrtarë publik dëshmia lëshohet nga institucioni/et përkatës në të cilën ka punuar zyrtari në pesë vitet e fundit).* Kandidatët e jashtëm paraqesin deklaratën me shkrim të vetë-nënshkruar, për të dëshmuar se ndaj tyre nuk ka pasur masë disiplinore të largimit nga pozita e zyrtarit publik në pesë vitet e fundit; • *certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;* • *si dhe çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit analizoj edhe Konkursin me numër RN00012425 i shpallur me datë 28.08.2023, ku si kriteret formale për pozitën përkatëse të punës janë vendosur: Arsimimi i kërkuar: *Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite të studimeve në drejtimit: fakulteti i Farmacisë, Ekonomikut, Juridikut, Kimisë, Mjekësisë, Biologjisë, Fizikes;* • Kualifikime të posaçme formale: • Përvoja e punës e kërkuar: *Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.* Ndërsa në klauzolën Nr. 7 si kriteret janë vendosur: *Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit;* • *Dëshmi për përvojën e punës / vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i*

punësimi për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë; • Përvoja e deklaruar e punës, sipas kushteve të konkursit, në Organizatat Joqeveritare, dëshmohet, përkatësisht merret parasysh, nëse kumulativisht përmbushen kushtet si në vijim. • “Është përgjegjësi e kandidatit që të sigurojë prova specifike që tregojnë se secili prej këtyre kritereve është përmbushur. Kandidatët gjithashtu duhet të bëjnë të qartë në aplikimin e tyre çdo përvojë pune që është fituar në një OJQ”: • Dëshmohet me statutin apo aktin tjetër të organizatës se pozita në të cilën është deklaruar përvoja e punës, ekziston në kuadër të organizimit dhe funksionimit të OJQ –së; • Aktin e emërimit apo caktimit me votim të organeve që sipas statutit të OJQ –së, kanë kompetencën për të emëruar/caktuar personat në pozitën e caktuar në OJQ; • Së paku njërën nga dëshmitë: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale ose të ardhurave tjera të tatueshme; • Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet nëse referencat e përvojës, mbështeten me aktet përkatëse noteriale; • Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në subjektet biznesorë private, deklarohet me dëshminë përkatëse së cilës i bashkëngjitet njëra nga dëshmitë mbështetëse si: pasqyra e fondit të kursimeve pensionale, pasqyra e obligimeve të paguara tatimore. • letër motivimi; • kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës (nuk pranohen nese janë me afat të skaduar); • dëshmi që nuk ka një masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publik në pesë vitet e fundit (për kandidatët që janë zyrtare publik dëshmia lëshohet nga institucioni/et përkatës në të cilën ka punuar zyrtari në pesë vitet e fundit). Kandidatët e jashtëm paraqesin deklaratën me shkrim të vetë-nënshkruar, për të dëshmuar se ndaj tyre nuk ka pasur masë disiplinore të largimit nga pozita e zyrtarit publik në pesë vitet e fundit; • certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit; • si dhe çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 88 dhe 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shqyrtuar edhe konkurset e shpallura nga njësia përgjegjëse në këtë rast Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, lidhur me pozita në kategorinë e njëjtë, gjegjësisht Kolegji mori parasysh Konkursin me numër reference RN000112058 i shpallur më datë 13.07.2023, për pozitën *Drejtori i Përgjithshëm* në Shërbimin Korrektues, klasa “Drejtues i Lartë 2” si dhe Konkursin me numër të referencës RN00012129, i shpallur me datë 20.07.2023, për pozitën *Drejtor i Përgjithshëm (2)* në Institutin e Kosovës për Administratë Publike-Ministria e Punëve të Brendshme, klasa “Drejtues i Lartë 2”, nga dhe është konstatuar së klauzolat me numër 7 të të dy këtyre konkurseve përmbajnë specifikime të njëjta lidhur me dokumentet e nevojshme të aplikimit ashtu siç janë përcaktuar edhe me konkursin e anuluar me numër të referencës RN00012066, rrjedhimisht, Konkursat me numër të referencës RN00012129 dhe RN000112058, me kërkesa të njëjta kanë vazhduar me fazën e verifikimit si fazë e parë e procesit të pranimit, kështu që në vlerësimin e Kolegjit veprimet e tilla të njësisë përgjegjëse cenojnë parimin e sigurisë juridike, dhe si të tilla përfaqësojnë praktikë jo të ligjshme në zbatimin e së drejtës materiale dhe njëkohësisht përbejnë trajtim jo të drejtë të kandidateve për pranim në shërbimin civilë.

Thënë me tepër, nga shqyrtimi i kërkesave të vendosura në klauzolën nr.7 të konkursit të anuluar me numër reference RN00012066 të datës 13.07.2023, për pozitën “*Drejtor Ekzekutiv* në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale- Ministria e Shëndetësisë citoj: ” *Dëshmi për përvojën e punës / vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimi për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë; Së paku njërën nga dëshmitë: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale ose të ardhurave tjera të tatueshme..*” në vlerësimin e Kolegjit kanë qenë kërkesa të mjaftueshme të cilat në vetvete kanë nënkuptuar përvojën në sektorin publik si dhe në atë privat, andaj, mbi bazën e këtyre fakteve, Kolegji i Këshillit konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me rastin e anulimit të Konkursit me numër reference RN00012066 të datës 13.07.2023 lidhur me pozitën për


Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale- Ministria e Shëndetësisë dhe ri shpalljes së konkursit për pozitën e njëjtë të punës, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas të cilit përcaktohet se: *1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme*”, ngase, po i njëjti organ në rast të lëshimeve përkatëse ka mundur të bëjë korrigjim të aktit të shpalljes së konkursit lidhur me pjesën kontestuese e jo të anuloj në tërësi konkursin përkatës.

Në vështrim të dispozitave të nenit 52 të Ligjit të Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerrë me shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale, konsiderohet akt i paligjshëm, andaj, nisur nga konstatimi si me lart, se Vendimi me Nr.1326/2023 i datës 28.08.2023 i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë është i përfshirë me të meta procedurale dhe materiale, ka vendosur për shfuqizimin e Konkursit me numër reference RN00012425 të datës 28.08.2023, ndërsa, ka lënë në fuqi Konkursin me numër reference RN00012066 të datës 13.07.2023 lidhur me pozitën Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, me detyrimin që të vazhdohet me fazat e mëtejme të vlerësimit të kandidateve sipas njoftimit mbi listën e ngushtë të datës 23.08.2023.

Theksuar si më lartë, e në mbështetje të dispozitave të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.2; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil, si dhe nenit 132, paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1136/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.